

Ndreqje gabimi

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.305, datë 12.3.2008 "Për përballimin e shpenzimeve të atashëve ushtarakë, të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, që shërbejnë në shtabet e Nato-s e në përfaqësitë ushtarake të Republikës së Shqipërisë pranë Nato-s, dhe të ushtarakëve shqiptarë, që shërbejnë pranë Organizatave Ndërkombëtare dhe në Shtabet Ushtarake Ndërkombëtare", botuar në Fletoren Zyrtare nr.49, datë 11 prill 2008, në pikën 1, faqja 2, pas germës "f" e deri te pika 2, korrigjohet si vijon:

Është:

- g) shpenzimet për pajisje shtëpiake;
- gj) shpenzimet për blerje automjeti, siguracion, mirëmbajtje;
- h) shpenzimet për karburant;
- i) shpenzimet për siguracion shëndetësor familjar;
- j) shpenzimet për taksa të shkollave publike, komisione bankare.

Kriteret, specifikimet dhe rastet e përballimit të shpenzimeve, të përcaktuara në shkronjat "e", "g", "gj" dhe "h" të kësaj pike, përcaktohen me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.

Bëhet:

- "g) shpenzimet energji elektrike, ujë, gaz, telefon fiks;
- gj) shpenzimet për pajisje shtëpiake;
- h) shpenzimet për blerje automjeti, siguracion, mirëmbajtje;
- i) shpenzimet për karburant;
- j) shpenzimet për siguracion shëndetësor familjar;
- k) shpenzimet për taksa të shkollave publike, komisione bankare.

Kriteret, specifikimet dhe rastet e përballimit të shpenzimeve, të përcaktuara në shkronjat "e", "gj" dhe "h" dhe "i" të kësaj pike, përcaktohen me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes".